



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.06.2020

Ref.: 566/2020

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 80-të, të mbajtur më 01.04.2020, mori:

## V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegji Universum (Nr.2119/19H, datë 31.10.2019) për akreditim/riakreditim të programeve të studimit si më poshtë:

- Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS,
- Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS,
- Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS,
- Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Kolegji Universum ka parashtruar kërkesën (Nr.2119/19H, datë 31.10.2019) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për akreditim të programeve të studimit si në vijim: Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, Fizioterapi BA Profesional, 180 ECTS, Higjienë Dentale, BA Profesional, 180 ECTS, Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS, Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2020 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Universum, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, sipas së cilit: *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë*



të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, erdhi në përfundim se programet e studimit: Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, Fizioterapi BA Profesional, 180 ECTS, Higjienë Dentale, BA Profesional, 180 ECTS, Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS, Gazetari Digjital, BA Profesional, 180 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Bazuar në nenin e referuar më sipër KSHC ka verifikuar të gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit të lartë cekura. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KSHC-së të mbajtur me 01.04.2020, dhe pas shqyrtimit të dosjes për secilin staf akademik, KSHC mori vendim që të refuzoj aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Universum.

- **Për programin e studimit:** Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji Universum, ka paraparë: Jusuf Mustafain, Arsim Rexhepin, Mirian Zenelin dhe Martina Mastandrea.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Universum, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universum për këtë program të studimit, u konstatua që Jusuf Mustafai, është i deklaruar në platformën e-akreditimi në dy Institucione të Arsimit të Lartë si profesor me marrëdhënie të plotë të punës. Sipas nenin 26, pika 5.3.14 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Një anëtar i stafit akademik që është i punësuar me orare të plotë (40 orë në javë) në një institucion të arsimit të lartë, mund të kryejë detyra në institucione të tjera të akredituara me më së shumti 10 orë angazhimi në ligjërata, ushtrime ose monitorim të kandidatëve, që nënkupton gjysmën e normës së plotë prej 20 orë pune”;* Rrjedhimisht pas verifikimit të angazhimit, ky staf akademik nuk mund të jetë bartës i programit. Ndërsa që Martina Mastandrea nuk posedon nostrifikim të diplomës nga MASHT, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, 5 dhe 6, thuhet që: *“Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do të nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT”.* Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës (nga MASHT, siç parashihet me këtë UA), të studimeve të doktoratës, e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës e këtij programi të studimit.

Sa i përket profesorëve Arsim Rexhepi dhe Mirian Zeneli, diploma e tyre nuk përkon me fushën e programit në të cilin ata janë bartës, dhe rrjedhimisht nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas Nenit 26, pika 5.3.4 të po të njëjtit UA.



Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Gjuhë Angleze BA 180 ECTS.

- **Për programin e studimit:** Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji Universum, ka paraparë: Zana Gergi, Bekim Ramabaja, Sylejman Myftari, Kaltrina Abazi, Vesa Rraci.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universum për këtë program të studimit, u konstatua, se: Zana Gergi dhe Bekim Ramabaja nuk kanë përvojë të mjaftueshme, sipas nenin 27, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse"* dhe për këtë nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës të këtij programi të studimit. Vesa Rraci nuk ka përvojë të mjaftueshme, sipas nenin 27, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse..."* si dhe nuk ka nostrifikim të diplomës nga MASHT, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi. Sipas Udhëzimit Administrativ 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 3, 5 dhe 6, thuhet që: *"Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do ti nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT"*. Mbi këtë bazë në mungesë të vendimit për nostrifikim të diplomës (nga MASHT, siç parashihet me këtë UA), e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës e këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Fizioterapi, BA Profesional, 180 ECTS.

**Për programin e studimit:** Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji Universum, ka paraparë: Afërdita Koshi, Naser Gjonbalaj, Ardian Biqaku.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universum për këtë program të studimit, u konstatua, se: Afërdita Koshi, Naser Gjonbalaj, Ardian Biqaku nuk kanë përvojë të mjaftueshme, sipas nenin 27, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse..."* për këtë nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës të këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Teknik i Radiologjisë, BA Profesional, 180 ECTS.

**Për programin e studimit:** Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, si bartës të këtij programi Kolegji Universum, ka paraparë: Arbenita Hoxha, Sami Shala, Afet Bela, Dafina Halili, Lavdim Hamiti, Venera Radoni.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universum për këtë program të studimit, u konstatua, se: Sami Shala, Afet Bela, Dafina Halili, Lavdim Hamiti, Venera Radoni nuk kanë përvojë të mjaftueshme, sipas nenin 27, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë relevante së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse,..”* për këtë, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë bartës të këtij programi të studimit.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Universum”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë